



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE**

**PROCESVERBAL**

**Për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt:**  
**“Blerje materiale pastrimi”**

I mbajtur sot në datë 15.08.2024, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje materiale pastrimi”**, me fondin limit **49 999 297** (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë) **Lekë pa Tvsh.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:  
*“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur.** Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.  
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”*

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsye të mëposhtme:

**Së pari**, kemi të bëjmë me mallra të destinuar për objekte të paracaktuara, pra nuk ka asnjë arsye apo shkak për ndarjen e procedurës në lote.

**Së dyti**, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, sigurimin me materialet e pastrimit për sigurimin e kushteve higjieno-sanitare të objekteve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë. Shpërndarja e këtyre produkteve do të realizohet nga kontraktuesi nën monitorimin e autoritetit kontraktor direkt në objektet arsimore sipas planit të shpërndarjes të hartuar nga autoriteti kontraktor në çdo kontratë. Magazinat e autoritetit kontraktor ndodhen në zonën Vaqarr të Bashkisë Tiranë dhe përqendrimi i mallit në magazinë dhe më pas realizimi i shpërndarjes do të sillte kosto shtesë për autoritetin kontraktor.

Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe shpërndarjen e mallit nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rëndësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtin mall, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin dhe shpërndarjen e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.